



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 489/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik LVV, ne te cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, në orën 13:00, QV Nr. 0814/C ne shkollën fillore “Avni Zhabeta” Shtupel-Kiline, kryesuesi i PDK-se Ismet Dautaj ka dashur te ndërroj komisionerin e LDK-se, kur ai ka refuzuar ka ndërhyrë truproja e Hashim Thaçit, Ilir Qollopeku. Komisionari i LDK-se prape ka refuzuar, prandaj është dashur qe komisionerët dhe vëzhguesit LDK-se te largohen nga vendvotimi”. Sipas parashtruesit te ankesës, procesi i votimit ne këtë QV është ndërprerë rreth orës 13:00. Gjithashtu pretendohet se ka pasur ndërhyrje te Ilir Qollopekut edhe ne QV Nr. 0814C/ 01R dhe QV Nr. 0814C/02R. Sipas parashtruesit te ankesës kjo përbën shkelje te nenit 76 paragrafi 1 te LPZ-se”.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se ka siguruar numër kontakt te Valon Dushit, ne cilësinë e dëshmitarit.

Ne raportin e policisë dt. 14.12.2010 me Nr. reference MBO-KL-183-10, te lëshuar nga togeri policor Rexhe Berisha , lënda “Njoftim lidhur me QV ne fshatin Shtupel” theksohet se : “*ne Klinë rreth orës 13:30 ka pasur nje mosmarrëveshje te vogel ne stafin zgjedhor, konkretisht midis komisionerit te PDK-se dhe komisionarit te LDK-se, për shkak te përcaktimit te vendeve te komisionereve. Si rrjedhim i kësaj mosmarrëveshjeje procesi zgjedhor është ndërprere 10 minuta dhe me pas ka filluar përsëri. Zyrtari komunal i zgjedhjeve Skender Veseli ka bisedua rme te dy*

komisioneret, ku pervec mosmarrëveshjes për vende qe ishte tejkaluar nuk ka pasur asnjë problem tjetër”.

Me rëndësi është fakti se sipas raportit policor me numër reference te cituar me larte ne vendngjarje nuk ka pasur asnjë problem sigurie. Gjithashtu sipas këtij raporti policor theksohet se kryesuesi i QV-se Skender Veselaj nuk konsideron se ka pasur ndërprerje te votimit, dhe se përgjegjësi i KKZ-se për atë QV nuk e ka njoftuar kryesuesin se procesi është ndërprerë, për me tepër përfaqësuesi i LDK-se Xheme Manaj nuk ka pasur asnjë ankese.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar nga subjekti politik PDK. Ky fakt konfirmohet edhe permes raportit te policisë dt. 14.12.2010 me Nr. reference MBO-KL-183-10, ne te cilin theksohet se ne QV Nr. 0814/C, dt, 12.12.2010 nuk pasur asnjë problem sigurie. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 489/2010 më datën 16.12.2010.

